



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.71, datë 30.03.2023

PËR

“NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR SHQYRTIMIN E ANKIMEVE KUNDËR VENDIMEVE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, PËR ARKIVIMIN E ANKIMIT OSE PUSHIMIN E HETIMIT DISIPLINOR NDAJ NJË PROKURORI”

Bazuar në nenet 160 pika 13, 164, 166 pika 2, 189, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit disiplinor ndaj një prokurori.
2. Komisioni do të përbëhet nga tre anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë të zgjedhur me short në seancën plenare të datës 30.03.2023, si më poshtë:
 - i. Zonja Eloida Goxhi
 - ii. Zonja Nurihan Seiti
 - iii. Zoti Tartar Bazaj
3. Kryetare e Komisionit caktohet zonja Eloida Goxhi.
4. Komisioni do të ushtrorë kompetencat e tij për shqyrtimin e ankimeve sipas përcaktimeve të nenit 160 pika 13, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, deri më datë 18.12.2023.
5. Ky vendim hyn menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 30.03.2023.

KRYETAR

Alfred Balla

